

Llakatund/ Policia gjen kallashnikovë dhe fidanë kanabisi, arrestohen 2 persona

10:16 08/09/2020

Share



77,461 Fansa

PËLQEJE

Një operacion policor i zhvilluar në fshatin Llakatund të Vlorës ka bërë të mundur arrestimin e dy personave.

Burimet zyrtare bëjnë me dije se dy personave të identifikuar me inicialet H.T dhe A.B u janë gjetur dy armë të tipit kallashnikovë dhe disa fidanë kanabis të cilët janë asgjësuar.

Autorët kishin kultivuar fidanët e kanabisit në pronë të tyre, si dhe iu kapën edhe 2 kallashnikovët.

NJOFTIMI NGA POLICIA

Vijon kontrolli masiv i territorit, për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve dhe armëmbajtjes pa leje.

Finalizohet nga Seksioni për Hetimin e Narkotikëve pranë DVP Vlorë dhe Komisariati i Policisë Vlorë, operacioni policor i koduar “Llakatundi”.

Sekuestrohen dy armë zjarri kallashnikov, si dhe asgjësohen fidanë të dyshuar narkotikë.

Vihen në pranga 2 shtetas, posedues të armëve të zjarrit dhe autorë të tentativës për kultivim të bimëve narkotike.

Në vijim të kontrollit masiv të territorit, me qëllim parandalimin, evidentimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e kultivimit të bimëve narkotike, bazuar dhe në informacionet e marra në rrugë operative, Seksioni për Hetimin e Narkotikëve në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë ka finalizuar operacionin e koduar “Llakatundi”, në kuadër të të cilit, në bashkëpunim me shërbimet e Komisarariatit të Policisë Vlorë, u bë kapja dhe arrestimi i shtetasve:

H. T., 40 vjeç dhe A. B., 50 vjeç, të dy me banim në fshatin Llakatund, Vlorë.

Si rezultat i këtij operacioni, Policia ka evidentuar dhe asgjësuar fidanë të dyshuar cannabis sativa, të cilat ishin kultivuar në pronën e këtyre shtetasve, në fshatin Llakatund.

Po gjatë operacionit, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan edhe 2 armë zjarri kallashnikov me municion luftarak, të cilat dyshohet se i posedonin këta shtetas.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë së Vlorës, për veprime të mëtejshme hetimore.

Like Share 1K people like this. Sign Up to see what your friends like.

ETIKETA kallashnikovë Llakatund policia Vlorë

Share

Lajme të tjera



Aksident në aksin Qafë Thanë-Prenjas/ Dy persona me urgjencë në spital

Aktualitet | 21:50 08/09/2020



Policia Rrugore me ‘dorë të hekurt’/ Pezullon 234 patentë në 72 orë, arrestohen 53 shoferë

Aktualitet | 20:04 08/09/2020



Kultivimi i drogës/ Policia në aksionin e korrjeve, katër zonat problematike me kanabis

Aktualitet | 07:49 08/09/2020



Policia Rrugore: Në 24 orë pezulluam 46 leje drejtimi, arrestohen 18 shoferë

Kronikë | 19:55 07/09/2020

Web TV



“HARD TALK NGA ROLAND QAFOKU”, i ftuar kryetari i bashkisë së...

21:35 31/08/2020



Fjala Sport në “Fjala TV”, nga Katerina Tafa. E premte, 31...

19:26 31/07/2020



Edicioni Informativ në “FJALA TV”. E Premte, 31 korrik 2020

14:23 31/07/2020

Fjala është e lirë. Liria është fuqi!

E-mail : info@fjala.al

Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të Fjala.al. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e FJALA.al, është shkelje e të drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi.

FJALA MEDIA GROUP
NUIS/NIPT : L92423005H

Na ndiqni në


[Facebook](#)

[Instagram](#)

[Youtube](#)